

## AKTI I THEMELIMIT

### Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (shpk)

#### Bazaar Group

Sot, me 06.06.2024, ne të nënshkruarit

**Anxhela Llalla**, lindur në Cerrik, Shqipëri, më 28.08.1993, shtetase shqiptare, mbajtëse e dokumentit identifikues Pasaportë me nr. Personal J35828010J, banuese në adresën: Rr. "5 Maji" Nd. 82, H.1, Nj. Admin. Nr. 4, Tiranë, madhor me zotësi të plotë për të vepruar.

b. **Okan Karakaya**, lindur në Konak, Izmir (Turqi) më 19.03.1993, shtetas turk, mbajtës i dokumentit identifikues Pasaportë me Nr. U23320651, banues në adresën: Rr. "5 Maji" Nd. 82, H.1, Nj. Admin. Nr. 4, Tiranë, madhor me zotësi të plotë për të vepruar.

b. **Melih Çaglar Koç**, lindur në Adana Turqi më 09.11.1984, shtetas turk, mbajtës i dokumentit identifikues Pasaportë me Nr. U25598778, banues në adresën: Rr. "Perlat Rexhepi", Nd. 17, H. 9, Nj. Admin. Nr. 5, Tiranë, madhor me zotësi të plotë për të vepruar.

Me vullnetin tonë të lirë dhe në përputhje me ligjin nr.9901, date 14.04.2008 "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (Ligji i Shoqërive) kemi vendosur të krijojmë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar **Bazaar Group** ("Shoqëria") duke nënshkruar këtë Akt Themelimi.

#### Neni 1

##### Emri dhe forma ligjore

1.1 Emri i shoqërisë do të jetë Bazaar Group, ndjekur në mënyrë të pandashme nga shkurtimi "shpk", cili përfaqëson formën ligjore të saj.

1.2 Shoqëria është një entitet ligjor shqiptar, dhe ka formën ligjore të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, në pajtim me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

1.3 Shoqëria mund të ndryshojë formën e saj ligjore në përputhje me parashikimet e legjislacionit shqiptar.

#### Neni 2

##### Selia dhe kohezigjatja

2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rr. "Don Bosko", Shk. 1, Ap. 64, ZK 8310, Tiranë. Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë selinë e saj në një adresë dhe/ose në një qytet tjetër të Shqipërisë.

2.3 Shoqëria mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi kudo brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

2.2 Kohezigjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

#### Neni 3

##### Objekti i veprimtarisë

3.1 Ndërtim, zhvillim dhe mirëmbajtje e faqes së webit si edhe aplikacionit në Android dhe IOS të Bazaar Group. Ndërmjetësim midis konsumatorit (blerësit) dhe shitësve (bizneseve) që kanë krijuar llogari në platformën e Bazaar Group në web ose app.



3.2 Ofrim i konsulencës, shërbimeve të marketingut dhe reklamimit për klientët (bizneset) e lidhura me platformën e Bazaar Group.

3.3 Ofrimi i shërbimeve logjistike nga Bazaar Group, nëpërmjet Postës Shqiptare, ose nëpërmjet nënkontraktimit me shoqëri ekzistuese që ofrojnë shërbime postare në të gjithë vendin dhe jashtë tij, për konsumatorët që kryejnë porosi nëpërmjet platformës së Bazaar Group.

3.4 Zhvillim, prodhim, import, eksport, blerje, shitje, magazinim, shpërndarje e mallrave, pajisjeve, makinerive, për llogari të saj ose të të tretëve konform kontratave të shërbimit.

3.5 Në përputhje me legjislacionin shqiptar, në mënyrë të të arrihet qëllimi i sipërpërmendur, shoqëria mund të kryejë edhe veprimet e mëposhtme:

- a. Të lidhë kontrata ose marrëveshje me persona fizikë, entitete private ose publike, organizata shqiptare apo të huaja;
- b. Të themelojë shoqëri shqiptare ose të huaja, apo të marrë pjesë në bashkime shoqërishe/joint venture, ose në lloje të ndryshme biznesesh që kanë objekt të ngjashëm me atë të shoqërisë;
- c. Të themelojë degë ose agjenci brenda ose jashtë territorit shqiptar;
- ç. Të marrë ose të japë hua, të pranojë ose të japë garanci personale apo të një lloji tjetër, të marrë përsipër detyrime dhe të lëshojë garanci të tjera kolaterale;
- d. Të ndërmarrë çfarëdo aktiviteti tjetër tregtar që lidhet dhe mbështet objektin e veprimtarisë së shoqërisë.

#### Neni 4

##### Kapitali fillestar dhe ndarja e tij

4.1. Kapitali i Shoqërisë do të jetë në total 300000 (njëqindmije) Lekë, 3 (tre) kuota, me një vlerë nominale prej 300000 (njëqind mijë) Lekë, plotësisht e nënshkruar dhe e shlyer nga ortakët.

4.2 Ortakët themelues të Shoqërisë dhe kuotat e zotëruara prej tyre në Shoqëri janë si mëposhtë:

a. **Anxhela Llalla**, lindur në Cerrik, Shqipëri, më 28.08.1993, shtetase shqiptare, mbajtëse e dokumentit identifikues Pasaportë me nr. Personal J35828010J, banuese në adresën: Rr. "5 Maji" Nd. 82, H.1, Nj. Admin. Nr. 4, Tiranë, zotëruese e 1 (një) kuote prej 33.3% me vlerë nominale 999000 lekë.

b. **Okan Karakaya**, lindur në Konak, Izmir (Turqi) më 19.03.1993, shtetas turk, mbajtës i dokumentit identifikues Pasaportë me Nr. U23320651, banues në adresën: Rr. "5 Maji" Nd. 82, H.1, Nj. Admin. Nr. 4, Tiranë, zotërues i 1 (një) kuote prej 33.3% me vlerë nominale 999000 lekë.

b. **Melih Çaglar Koç**, lindur në Adana Turqi më 09.11.1984, shtetas turk, mbajtës i dokumentit identifikues Pasaportë me Nr. U25598778, banues në adresën: Rr. "Perlat Rexhepi", Nd. 17, H. 9, Nj. Admin. Nr. 5, Tiranë, zotërues i 1 (një) kuote prej 33.4% me vlerë nominale 100200 lekë.

#### Neni 5

##### Transferimi, zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit


5.1 Transferimi, zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit bëhet i sipas parashikimeve në Statut.

#### Neni 6

##### Organet drejtuese dhe administrimi

6.1 Shoqëria drejtohet dhe administrohet nga Administratori/ët e shoqërisë dhe organet e saj janë si më poshtë:

7.9/205



a. Asambleja e Përgjithshme

b. Administratori

6.2 Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme dhe Administratorit përcaktohen në Statutin e shoqërisë.

6.3 Administratori i parë i shoqërisë do jetë Z. Melih Çaglar Koç. Administratori zgjidhet në përputhje me Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe emërohet për një periudhë 3 vjeçare.

#### Neni 7

#### Të tjera

7.1 Ky Akt Themelimi hartohet në gjuhën shqipe në 3 (tre) kopje identike me të njejtën fuqi ligjore. Ky Akt Themelimi iu lexua ortakëve themelues, u gjend i rregullt dhe në përputhje me Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".


7.2 Të gjithë ortakët deklarojnë se e njohin dhe kuptojnë gjuhën shqipe si edhe e nënshkruajnë atë rregullisht, sot më datë 06/06/2024.

#### ORTAKËT THEMELUES

ANXHELA LLALLA



OKAN KARAKAYA



MELIH ÇAGLAR KOÇ

Melih Çaglar Koç  
